


# DIALOGU KOSOVË - SERBI GJATË SESIONIT PRANVEROR TË LEGJISLATURËS SË TETË TË KUVENDIT TË KOSOVËS

(MARS – GUSHT 2021)



SHTATOR, 2021





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e zhvillimit  
të demokracisë pjesëmarrëse dhe luftës  
kundër korrupsion përmes promovimit të  
transparencës, llogaridhënies dhe integritetit  
në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

E DREJTA E AUTORIT © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Layout and design: **envinion**

Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Promovimi i një procesi të mirinformuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi" i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

# PËRMBAJTJA

6

HYRJE

7-9

DIALOGU NË SEANCAT E  
KUVENDIT

10-12

1. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE  
NË SEANCA

- 1.1 Interpelancat
- 1.2 Debatet parlamentare
- 1.3 Raportimet dhe informimet e kryeministrit
- 1.4 Pyetjet parlamentare

13-19

2. DIALOGU NË KOMISIONET  
PARLAMENTARE

- 2.1 Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
- 2.2 Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
- 2.3 Komisioni për Integrim Evropian
- 2.4 Komisioni për Mbiqëqyrjen e Financave Publike
- 2.5 Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbiqëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit
- 2.6 Diskutimet rreth dialogut në komisionet tjera

20

PËRFUNDIME DHE  
REKOMANDIME

22

SHTOJÇË



# Hyrje

Legjislatura e tetë e Kuvendit të Kosovës filloi më 22 mars 2021, duke pasur legjislaturën paraprake e cila ishte dhe më e shkurtra në historinë e Kuvendit të Kosovës. Kjo legjislaturë u formua pa vonesa dhe ndryshe nga legjislatura e kaluar parashikohet të ketë stabilitet të numrave. Rezultatet e zgjedhjeve të 17 shkurtit 2021 nxorën fituese Lëvizjen Vetëvendosje që mori rreth 51% të votave qytetare. Dialogu Kosovë-Serbi kishte qenë një ndër përcaktuesit kryesor të dy qeverive paraprake. Në Qeverinë LVV-LDK kishte shtyrë në rënien e Qeverisë për shkak të mosdakordimeve në mes partnerëve qeverisës dhe votës së mosbesimit ndaj Qeverisë e cila u mbështet dhe nga subjektet politike opozitare. Ndërsa në Qeverinë që pasoi me në krye Kryeministrin Avdullah Hoti ndër temat kryesore ishte dhe arritja e Marrëveshjes apo Zotimeve të Uashingtonit më 4 shtator 2020 në Uashington.

Këto zhvillime ndikuan dhe në mbarëvajtjen dhe dinamikën e punës së Kuvendit, të cilat Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) i ka paraqitur në raportin e veçantë të monitorimit për këtë sesion të parë të legjislaturës, duke u fokusuar në trajtimin e çështjes së dialogut nga Kuvendi në përgjithësi.

Ky raport është i ndarë në disa seksione, të cilat pasqyrojnë punën e Kuvendit në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, ligjvënës dhe përfaqësues për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Në pjesën e parë të punimit, ofrohen të dhëna të përgjithshme mbi trajtimin që i është bërë dialogut me Serbinë në seancat e Kuvendit. Aty ofrohen të dhëna edhe mbi diskutimet që i kanë karakterizuar ato seanca ku është diskutuar dialogu.

Në pjesën e dytë të punimit, ofrohet një vlerësim i mbikëqyrjes që Kuvendi i'a ka bërë ekzekutivit në raport me procesin e dialogut, gjatë seancave plenare. Po ashtu, në këtë seksion bëhet një vlerësim i nivelit të ushtrimit të secilit mekanizëm mbikëqyrës që deputetët kanë në dispozicion, duke përfshirë interpelancat, debatet parlamentare, raportimet ose diskutimet e kryeministrit, si dhe pyetjet parlamentare.

Pjesa e tretë e punimit konsiston në vlerësimin e punës së komisioneve parlamentare në relacion me dialogun me Serbinë. Theks i veçantë në këtë pjesë i është kushtuar punës së disa prej komisioneve parlamentare që kanë pasur performancë më të mirë në mbikëqyrjen e dialogut.

Në fund të punimit, janë dhënë përfundime, në formë të konkluzioneve kryesore të të gjeturave të këtij raporti, si dhe janë ofruar rekomandime për përmirësimin e performancës së deputetëve në raport me dialogun Kosovë-Serbi.





# Dialogu në seancat e Kuvendit

Qeveria e drejtuar nga Kryeministri Albin Kurti nuk do të trajtonte çështjen e dialogut Kosovë-Serbi si çështje primare të qeverisjes. Tashmë i rifilluar, dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian do të vazhdonte nën ndërmjetësimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri Joseph Borrell, respektivisht nga Emisari Special Miroslav Lajčak. Qeveria e Kosovës emëroi Zëvendëskryeminstriin e Kosovës Besnik Bislimi, kryenegociator në dialogun me Serbinë. Gjithsesi dialogu gjatë periudhës që përkon me sesionin pranveror të Kuvendit u zhvillua me hapa të ngadaltë, gjatë së cilës pati takime dhe të nivelit të lartë por që nuk prodhuan rezultate konkrete apo marrëveshje të reja.

Ky fakt ndikoi dhe në fokusin që Kuvendi ia dha kësaj teme, duke bërë që dialogu të jetë pjesë e diskutimeve në Kuvend, por duke mos u trajtuar si temë e veçantë, me vetëm tri raste kur dialogu ishte si pjesë e rendit të ditës. Ndërsa nuk kishte asnjë interpelancë e veçantë lidhur me procesin e dialogut. Në interpelancën ku u ftua Ministri i Financave, Punës dhe Transfere, Hekuran Murati lidhur me "uljen e shtesave të pensionistëve, stafit shëndetësor dhe institucioneve të sigurisë", u ngrit çështja e fondit pensional të marrë nga Serbia. Gjatë këtij sesioni, nuk u miratua asnjë rezolutë lidhur me çështjen e dialogut.

Çështjet që ndërlidhen me procesin e dialogut në përgjithësi u trajtuan gjatë periudhës së deklarimeve jashtë rendit të ditës, apo pikave tjera që nuk ishin paraparë të trajtojnë drejtpërdrejtë çështjen e dialogut. Si pikë e rendit të ditës, dialogu ka qenë pjesë në vetëm 22% të të gjitha seancave, përkatësisht në katër nga 18 seancat ku është trajtuar dialogu. Krahasuar me legjislaturën e kaluar, ka një ulje të ndjeshme të trajtimit të kësaj çështjeje si pjesë e rendit të ditës. Ndërsa, në 14 raste të tjera, dialogu është trajtuar vetëm si çështje në mesin e diskutimeve që janë zhvilluar lidhur me çështje të caktuara.

Për herë të parë si pjesë e rendit të ditës, tema e mbulimit të humbjeve për pjesën veriore të Kosovës ku qytetarët nuk paguajnë për konsumimin e energjisë u diskutua më 6 maj. Kjo temë ishte diskutuar paraprakisht në Komisionin parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ku ishte dakorduar për rekomandim të aprovimit të kërkesës së NP KOSTT për sigurimin e mjeteve të nevojshme përmes votimit në seancë plenare. Në këtë seancë u elaborua rekomandimi i këtij Komisioni i cili më pas me votat e 61 deputetëve të Kuvendit të Kosovës u miratua.<sup>1</sup> Partitë opozitare nuk ishin deklaruar fare gjatë asaj seance, ndonëse ekzekutivi ishte kritikuar për këtë çështje gjatë trajtimit të saj në komisionin përkatës



Dialogu si çështje është trajtuar – si pikë e veçantë e rendit të ditës apo vetëm si diskutim – në



# 18

prej  
gjithsej



# 23

Seancave të  
mbajtura

**prej të cilave 16 ishin të rregullta, katër të jashtëzakonshme dhe dy solemne.**

<sup>1</sup> Për më shumë shih: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_05\\_06\\_ts\\_Seanca\\_STJJBpdAp.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_05_06_ts_Seanca_STJJBpdAp.pdf)



parlamentar. Ndërsa, më 12 gusht 2021, çështja e mbulimit të shpenzimeve për energjinë e shpenzuar në komunat në veri të vendit u ngrit si çështje, përkatësisht nga deputetja e LDK-së Valentina Bunjaku-Rexhepi. Në këtë seancë si pikë e rendit të ditës ishte shqyrtimi i raportit me rekomandime lidhur me problemet e evidentuara në NP KOSTT sh.a.

Një diskutim lidhur me ecurinë e deritanishme të procesit të dialogut me Serbinë si pjesë e rendit të ditës do të mbahej më 11 qershor 2011. Gjatë kësaj seance Kryeministri Kurti paraqiti raportin e zbatimit të marrëveshjeve të kaluara duke theksuar se Qeveria e Kosovës po vazhdon dialogun e mirë-përgatitur dhe që në këtë proces nuk do të cenohet interesi i Kosovës. Në këtë seancë deputetët nga partitë opozitare kritikuan qasjen e Qeverisë Kurti ndaj dialogun me Serbinë duke kërkuar më shumë transparencë, llogaridhënie dhe përbushje të zotimeve të dhëna prej tij.<sup>2</sup>

Si pikë e veçantë e rendit të ditës, dialogu do të adresohet edhe në debatin parlamentar të ftuar nga LDK lidhur me Marrëveshjen e Uashingtonit. Në këtë seancë ish-Kryeministri i Kosovës Avdullah Hoti tani në cilësinë e deputetit të Kuvendit në fjalimin e tij mbështeti sërish marrëveshjen e Uashingtonit, qëndrim që u nda dhe nga deputetë të tjera nga kjo parti. U.D. e detyrës së shëfës së grupit parlamentar të LVV-së Mimoza Kusari-Lila u shpreh që qeveria do ta zbatojë këtë marrëveshje por jo aty ku cenohet interesi i Kosovës. PDK kërkoj qartësim të pozicionit të Qeverisë së Kosovës lidhur me këtë marrëveshje ndërsa u kërkua edhe ruajtura e raporteve me SHBA-të nga shëf i grupit parlamentar të AAK-së Besnik Tahiri. Kryeministri Kurti në përgjigjet dhe elaborimin e tij kritikoi pika të caktuara të kësaj marrëveshjeje.<sup>3</sup>

Dialogu ishte pjesë e një seancë të veçantë në kuadër të së cilës Ministri i Punëve të Jashtme të Italisë Luigi Di Maio pati adresim në Kuvend të Kosovës. Në fjalën e tij, Kryeministri Kurti shprehu gatishmërinë e Kosovës për takime dhe dialog duke synuar siç tha ai "arritjen e njohjes së dyanshme, siç është shprehur edhe presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Joe Biden"<sup>4</sup>. Ai shtoi se zgjidhja e këtij problemi është vetëm njohja e pavarësisë së Kosovës e cila do të ndihmonte dhe Serbinë të çlirohej nga mentaliteti "sundues e spastrues të trashëguar nga

Milloshëviqi". Në fjalimin e tij Kryeministri Kurti ndau në pika të përgjithshme dhe pritshmëritë lidhur me procesin e dialogut, duke përmendur pikat e artikuluar dhe në takimet në Bruksel siç tha si arritjen e një pakti të paqes dhe të mosulmimit me Serbinë, duke ofruar reciprocitet pas njohjes për gjithçka, përfshirë dhe trajtimin e pakicave, largimin e kriminelëve të luftës nga institucionet që trajtojnë çështjen e personave të zhdukur me dhunë. Çështjen e dialogut e adresoi edhe Ministri i Jashtëm në fjalimin e tij ku ndër të tjera e vlerësoi si një "mundësi historike" që duhet të shfrytëzohet nga të dyja palët. Ai për më tepër shtoi, se pavarësisht ndjeshmërisë të temës nuk kishte "asgjë për tu frikësuar nga ky dialog".

## Dialogu – temë bosht e seancave të jashtëzakonshme

Dialogu do të përmendej edhe në tre raste në seanca të jashtëzakonshme: në fillim të legjislaturës, gjatë zgjedhjes së Qeverisë së Kosovës dhe në rastin tjetër në zgjedhjen e Presidentes së Kosovës. Në rastin e parë, në ekspozenë e bërë nga Albin Kurti, si i nominuar për Kryeministër të Kosovës ai përmendi dhe çështjen e dialogut Kosovë-Serbi. Lidhur me këtë çështje ai tha se çështjen e hapura me Serbinë duhet të adresoheshin nëpërmjet dialogut, ku fati i personave të zhdukur ishte prioritar. Ai shtoi se dialogu duhet të adresonte çështjen e fondit pensional, kthimin e fondeve të marra nga ana e Serbisë për keqpërdorimin e energjisë elektrike, adresimin e dëmeve të luftës, për borxhet e për suksesionet.<sup>5</sup> Gjithashtu në prezantimin e kabinetit të tij, njoftoi deputetët e Kuvendit të Kosovës se çështjen e dialogut si pjesë të portofolio-s do ta mbulonte Zëvendëskryeministri i parë për integritet evropian, zhvillim dhe dialog, Besnik Bilsimi.

Në këtë seancë të jashtëzakonshme, çështjen e dialogut do ta ngrisin pothuajse të gjithë deputetët opozitar që morën fjalën të cilët do të preknin aspekte të ndryshme duke kërkuar më shumë sqarime lidhur me formatin, qëndrimet e qeverisë 'Kurti 2' dhe nëse do mbaheshin qëndrimet e njëjta të artikuluar më parë përfshirë kërkesën për kërkim falje nga ana e Serbisë.

2 Për më shumë shih: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_06\\_11\\_ts\\_Seanca\\_EhJAgJFeHg.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_06_11_ts_Seanca_EhJAgJFeHg.pdf)

3 Për më shumë shih: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_07\\_07\\_ts\\_Seanca\\_v9ëUJPNqvh.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_07_07_ts_Seanca_v9ëUJPNqvh.pdf)

4 Për më shumë shih: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_06\\_22\\_ts\\_Seanca\\_HYxHyAx9By.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_06_22_ts_Seanca_HYxHyAx9By.pdf)

5 Për më shumë shih: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_03\\_22\\_ts\\_Seanca\\_RhPegcUngV.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_03_22_ts_Seanca_RhPegcUngV.pdf)





Presidentja Osmani-Sadriu tha se dialogu është rruga që Kosova ka përpara duke nënvizuar që ai duhet të jetë i drejtë, i barabartë duke shtuar që paqja arrihet me kërkim faljen nga ana e Serbisë dhe drejtësinë për krimet e kryera. Ajo foli dhe për krimet e kryera në Kosovë gjatë kohës së luftës nga forcat serbe.

Një tjetër seancë e jashtëzakonshme ku do të ngritjes çështja e dialogut me Serbinë do të ishte dhe gjatë zgjedhjes së Presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu. Kjo çështje do të zinte vend në fjalimin e Presidentes Osmani-Sadriu drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve pas zgjedhjes së të njëjtës. Presidentja Osmani-Sadriu tha se dialogu është rruga që Kosova ka përpara duke nënvizuar që ai duhet të jetë i drejtë, i barabartë duke shtuar që paqja arrihet me kërkim faljen nga ana e Serbisë dhe drejtësinë për krimet e kryera. Ajo foli dhe për krimet e kryera në Kosovë gjatë kohës së luftës nga forcat serbe.<sup>6</sup>

Seanca e tretë e jashtëzakonshme ku do të përmendej çështja e dialogut ishte gjatë prezantimit të programit të Qeverisë Kurti për vitet 2021-2025 e cila u mbajt më 17 dhe 19 maj 2021. Në këtë seancë Kryeministri Kurti elaboroi programin qeverisës ku çështjen e dialogut e prezantoi si pjesë të politikës së jashtme. Ai tha se zgjidhja e çështjeve të hapura me Serbinë dukej të arrihej nëpërmjet një dialogu parimor, si palë të barabarta dhe se Kosova do të ishte palë dhe jo temë e dialogut. Ai kërkoi që të ketë pajtim me opozitën karshi politikës me Serbinë duke shtuar se trashëgimia e lënë nga pushteti i dikurshëm do të merrte pjesën më të madhe të energjisë për "zhbërjen e dëmit të shkaktuar, Marrëveshjen për Asociacionin, Marrëveshja për Fusnotën, Marrëveshjet për Gjykatat e Universitetin paralel në Veri të Mitrovicës, hapjen e çështjes së statusit, krijimin e diskursit për shkëmbime territoriale e marrëveshje të tjera të dëmshme ju na i latë trashëgim."<sup>7</sup>

Në fjalën që deputetët e Kuvendit morën, ata adresuan dhe çështjen e dialogut të prezantuar në programin e Qeverisë ku nuk munguan kritikata nga ana e deputetëve të opozitës, kërkesave të tyre për më shumë sqarime si dhe pyetjeve drejtuar Kryeministrit Kurti lidhur me qëndrimet e subjektit të tij të shprehura ndër vite.

Ndryshe nga e kaluara ku Rezolutat lidhur me procesin e dialogut ishin ndër pikat më polarizuese në mes pozitës dhe opozitës, përgjatë dy qeverive të ndryshme gjatë asaj legjislatore, në këtë sesion nuk u miratua asnjë rezolutë lidhur me procesin e dialogut. Draft rezolutat e propozuara nga opozita nuk u mbështet, vetëm një rezolutë e sponsorizuar nga LVV dhe LDK në kohën e qeverisjes së tyre kaloi. Ndryshe gjatë sesionit pranveror të legjislaturës së tetë duket që opozita nuk morri iniciativa të shumta të propozimit e draft rezolutave. Në vetëm një rast pas debatit parlamentar të iniciuar nga LDK lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit i mbajtur më 7 korrik kishte një draft rezolutë. Kjo rezolutë ftoi Qeverinë e Kosovës që të zbatojë këtë marrëveshje dhe të përgatisë një plan veprimi të cilin duhet ta dorëzonte në Kuvend. Në seancë prezent ishin 83 deputetë të Kuvendit në të cilën 57 deputetë nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje abstenuan ndërsa vetëm 24 deputetë të LDK-së votuan për këtë rezolutë. Si rezultat kjo draft rezolutë nuk u miratua në Kuvend të Kosovës. Gjatë këtij sesioni, nuk kishte asnjë nismë për rezoluta lidhur me proces të dialogut të propozuar nga shumica parlamentare.

6 Për më shumë shih: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_04\\_03\\_ts\\_Seanca\\_yj5PSJPSVy.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_04_03_ts_Seanca_yj5PSJPSVy.pdf)

7 Për më shumë shih: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_05\\_17\\_ts\\_Seanca\\_Lq3mtvq3xf.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_05_17_ts_Seanca_Lq3mtvq3xf.pdf)





# 1. Mbikëqyrja parlamentare në seanca

Përkundër kuadrit relativisht të konsoliduar që ofrohet nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për mbikëqyrjen parlamentare, gjatë këtij sesioni deputetët nuk kanë ushtruar efektivisht dhe në masë të duhur mekanizmat në dispozicion për mbikëqyrje. Përgjithësisht, mekanizmat e mbajtjes e ekzekutivit llogaridhënës në raport me dialogun ishin interpelancat, debatet parlamentare, raportimet e kryeministrit dhe pyetjet parlamentare.

## 1.1 Interpelancat

Ndonëse në legjislaturën e kaluar, interpelancat ishin përdorur si një formë e mbikëqyrjes dhe kërkesës për llogaridhënia nga ana e Qeverisë, përkatësisht në pesë raste nga Lëvizja Vetëvendosje dhe në një rast nga Partia Demokratike të Kosovës, gjatë sesionit pranveror të legjislaturës së tetë, nuk pati asnjë interpelancë të veçantë të iniciuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës qoftë nga radhët e pozitës apo opozitës lidhur me procesin e dialogut. Pavarësisht faktit që gjatë kësaj periudhe, Kryeministri i vendit Albin Kurti kishte mbajtur dy takime të ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian në Bruksel, prezantimit të qasjes së Qeverisë së tij lidhur me dialogun, takimeve të nivelit të krye-negociatorëve të cilët u mbajtën, deputetët e Kuvendit nuk vlerësuan si të domosdoshme thirrjen e asnjë interpelance lidhur me këtë çështje. Ashtu siç u theksua më lartë, në interpelancën e ftuar për çështjen e uljes së shtesave të pensionistëve, stafit shëndetësor dhe institucioneve të sigurisë, Ministri i Financave, deputetja nga radhët e VV-së Arbëreshë Kryeziu-Hyseni ngriti çështjen e fondit pensional të marr nga Serbia.

## 1.2 Debatet parlamentare

Debatet parlamentare janë formë e ushtrimit të mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, duke u ofruar të gjithë deputetëve më shumë hapësirë kohore që të paraqesin

pikëpamjet e tyre dhe të parashtrojnë pyetje apo të ngritin tema lidhur me çështje të caktuara. Për dallim nga interpelancat, debatet parlamentare nuk kanë kohëzgjatje të kufizuar, ndërsa deputetëve u ofrohet minutazhë e njëjtë sikur në diskutimet tjera të rëndomta. Në anën tjetër, debatet nuk janë të targetuara domosdo ndaj një anëtari të ekzekutivit, por mund të përfshijë në diskutime numër më të madh të pjesëmarrësve.

Gjatë sesionit pranveror të legjislaturës së tetë janë mbajtur gjithsej gjashtë debate parlamentare, ndër të cilat çështja e dialogut ishte pjesë e dy prej tyre. Njëri prej debateve parlamentare ishte drejtpërdrejt i lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit, ndërsa tjetri debat parlamentar ishte ftuar lidhur me punën 100 ditore të Qeverisë së Kosovës, në kuadër të së cilës pashmangshëm u trajtua edhe çështja e dialogut dhe temat e ndërlidhura me të.

Debati i parë parlamentar ishte thirrur nga grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, më 7 korrik, lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit. Fillimisht, gjatë prezantimit të çështjes, Avdullah Hoti, i cili ishte njëkohësisht nënshkruar i asaj marrëveshje gjatë kohës sa ishte kryeministër vitin e kaluar, kishte deklaruar që distanca kohore që nga arritja e marrëveshjes ishte më se e mjaftueshme për të reflektuar mbi rëndësinë e saj. Gjatë kësaj pjese, Hoti kishte mbrojtur arritjen e kësaj marrëveshje, kishte akuzuar ekzekutivin aktual për populizëm në raport me këtë marrëveshje, si dhe kishte kërkuar nga qeveria që t'a trajtojë me prioritet partneritetin me SHBA-të.

Gjatë diskutimeve të deputetëve të grupeve parlamentare ishin shpërfaqur përplasje të shumta, veçanërisht mes deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe atyre të opozitës, e sidomos të LDK-së. Të njëjtit kishin shkëmbyer akuza e kundër-akuza përgjatë tërë diskutimit, me të dyja palët që ishin të barrikaduara në qëndrimet mbrojtëse për punët



e tyre në relacion me procesin e dialogut. Argumente në favor të nënshkrimit të asaj marrëveshje ish-in dhënë edhe nga deputetë të grupit parlamentar të AAK-së, subjekt politik ky i cili gjatë kohës kur ishte arritur Marrëveshja e Uashingtonit ish-in pjesë e koalicionit qeverisës. Ata kishin ndjekur linjën e njëjtë të kërkesave për partneritetin me SHBA-të, sikur edhe subjektet tjera opozitare. Në anën tjetër, deputetët e grupit parlamentar të PDK-së kishte kërkuar më shumë elaborim nga ana e Qeverisë për këtë marrëveshje, si dhe kishin ngritur pyetje lidhur me qëndrimin e qeverisë për pikat specifike të marrëveshjeve.

Kurse, gjatë fjalës së tij, kryeministri Albin Kurti kishte kritikuar qeverinë paraprake lidhur me atë që, sipas tij, i ishte hapur dera Serbisë për në Shtëpinë e Bardhë, pikërisht nga kjo marrëveshje. Kryeministri Kurti po ashtu kishte elaboruar qëndrimin e tij kundërshtues në raport me disa prej elementeve të marrëveshjeve, sidomos atë për moratoriumin për anëtarësim në organizata ndërkombëtare për një vit nga ana e Kosovës.

Subjektet opozitare kishin kritikuar kryeministrin Kurti për mospjesëmarrje gjatë të gjithë kohës kur diskutohej kjo pikë e rendit të ditës, por vetëm në një periudhë të shkurtër të saj.

Debati i dytë parlamentar gjatë së cilit ishte trajtuar dialogu dhe çështjet e ndërlidhura me të, ishte më 2 dhe respektivisht 3 gusht, gjatë debatit parlamentar lidhur me punën 100 ditore të Qeverisë. Ky debat parlamentar ishte thirrur nga grupi parlamentar i PDK-së, përkatësisht nga nëntë deputetë nënshkrues. Gjatë prezantimit fillestar, Abelard Tahiri nga PDK kishte dhënë kritika të shumta ndaj ekzekutivit për vazhdimin e dialogut pa një platformë të qartë, pa dhënë llogari para Kuvendit, si dhe duke shkelur disa prej premtimeve që, sipas tij, ish-in dhënë nga kryeministri Kurti para se ai të vinte në pushtet. Kritika ndaj qeverisë për çështjen e dialogut kishin shpalosur edhe deputetët tjerë të subjekteve opozitare. Shumica e diskutimeve të deputetëve lidhur me dialogun, respektivisht punën e qeverisë në këtë drejtim, përmbanin akuza të shumta mes pozitës dhe opozitës. Deputetët opozitarë kishin kërkuar që dialogu të mbetet ndër prioritetet e para të Kosovës, ndonëse sipas tyre, kryeministri kishte ndërruar qëndrim sa i përket nivelit të prioritetit që i takon kësaj çështje. Në anën tjetër, deputetët nga radhët e shumicës parlamentare vazhdimisht tentuan që raportin 100 ditësh të Qeverisë t'a ndërlidhin me çështjen e luftimit të pandemisë dhe rimëkëmbjes

ekonomike, duke tentuar të mos diskutojnë drejtpërdrejtë për dialogun në shumicën e rasteve.

Kurse, kryeministri Kurti, në rastet kur kishte marrë fjalën për të diskutuar për çështjen e dialogut, kishte shtruar nevojën për vendosjen e reciprocitetit, si dhe kishte mbajtur qëndrim për vazhdimin e dialogut, sipas tij, ndryshe nga mënyra si është dialoguar deri më tani.

### 1.3 Raportimet dhe informimet e kryeministrit

Ndryshe nga legjislatura paraprake, ku gjatë Qeverisë së udhëhequr nga Avdullah Hoti ish-in mbajtur janë mbajtur disa seanca në kuadër të së cilave ka pasur raportime të Kryeministrit lidhur me zhvillimet, ecurinë dhe progresin në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi, në sesionin pranveror të kësaj legjislature ka pasur vetëm një elaborim të çështjes së dialogut në formë të diskutimit nga Kryeministri.

Ky diskutim ishte thirrur nga kryeministri Albin Kurti më 11 qershor, vetëm një ditë pas publikimit të raportimit mbi gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve nga zëvendës-kryeministri Besnik Bislimi, dhe dërgimit të këtij raporti nga zëvendëskryeministri tek Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca. Gjatë fjalimit hyrës, kryeministri Kurti kishte njoftuar se diskutimi kishte të bënte me ecurinë e deriatëhershme të procesit të dialogut me Serbinë, bazuar pikërisht në raportin për gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të dialogut. Kryeministri Kurti kishte kritikuar shumë prej marrëveshjeve të arritura në dialog, të cilat sipas tij ish-in në dëm të Kosovës. Ai po ashtu kishte kërkuar konsensus nga subjektet politike opozitare, duke kërkuar nga to që njëkohësisht Kosova të mos trajtohet si peng i marrëveshjes me Serbinë.

Gjatë seancës, deputetët nga radhët e subjekteve politike opozitare kritikuan qasjen e Qeverisë ndaj dialogut me Serbinë, duke kërkuar më shumë transparencë, llogaridhënie dhe përmbushje të zotimeve të dhëna prej tij.

Ngjashëm sikur në të gjitha rastet tjera kur ishte diskutuar për dialogun, edhe në kuadër të diskutimeve të kësaj pike të rendit të ditës gjatë seancës, kishte pasur përplasje të shumta mes deputetëve të opozitës me ata të pozitës, e madje edhe me anëtarët e kabinetit qeveritar, në veçanti kryeministrin Kurti.



## 1.4 Pyetjet parlamentare

Pyetjet parlamentare janë një ndër mekanizmat mbikëqyrës të cilat deputetët e Kuvendit kanë në dispozicion për të kërkuar llogari nga anëtarët e Qeverisë. Gjatë sesionit pranveror të legjislaturës së tetë, 39 deputetë të Kuvendit kanë parashtruar gjithsej 108 pyetje parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar. Nga numri i përgjithshëm i pyetjeve parlamentare, 13 prej tyre kishin në fokus çështjet që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi, apo 12% të tyre. Krahasuar më tërë legjislaturën e shtatë, mund të thuhet që ka një ngritje në numrin e pyetjeve të parashtruara nga deputetët ku në atë parapraken ishin vetëm shtatë pyetje apo vetëm 4% e tyre lidhur me çështjen e dialogut.

Vetëm njëra nga pyetjet drejtuar kabinetit qeveritar u bë nga një deputet i LVV-së, përkatësisht Gani Krasniqi drejtuar Ministrit të Planifikimit Hapësinor Liburn Aliu lidhur me ndërtimet në veri të vendit. Ndërsa pyetjet e tjera u ngritën nga deputetë të opozitës ku çështjen që mbizotëruan ishte çështja e energjisë elektrike në veri, marrëveshja e 19 prillit, ndërtimi i Universitetit në veri të Mitrovicës me fondet e Serbisë si dhe ndërtimeve të objekteve banesore në atë pjesë të vendit po me fonde të Serbisë. Sigurisht se nuk munguan as pyetje lidhur me platformën e Qeverisë ndaj dialogut ku u kërkuar që e njëjta të sillte në Kuvend, reciprocitetin ndaj Serbisë, asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe si dhe aspektet e sigurisë dhe operimit të grupeve kriminale në veri të vendit.

Natyrë e këtyre pyetjeve ishte përputhje me zhvillimet politike lidhur me procesin e dialogut apo dhe zhvillimet në terren. Gjithsesi se deputetët e opozitës shtruan dhe pyetje ndaj kabinetit qeveritar që kishin të bënin me qëndrimet e artikuluar më parë nga Lëvizja Vetëvendosje lidhur me çështje të caktuara edhe gjatë kohës kur nuk ishte në pushtet. Pyetjet e ngritura iu drejtuan Kryeministrit Kurti si dhe ministrave të Qeverisë dhe vetëm dy prej tyre nuk patën përgjigje.

Një ndër to ishte dhe çështja e energjisë në veri duke konsideruar që pavarësisht faktit që Kosova arriti marrëveshje të kyçjes në mes KOSTT dhe ENTSO-e, çështja e faturimit të energjisë elektrike në katër komunitetë e veriut të vendit nuk u zgjidh. Në të kaluarën, Qeveria e Kosovës kishte ndarë fond për mbulimin e këtyre shpenzimeve, veprim që ishte kritikuar nga opozita e atëherëshme përfshirë Lëvizjen Vetëvendosje prandaj dhe opozita e tanishme insistonte në kërkesat e saj për të kërkuar llogari nga Qeveria se si do të adresojë këtë problematikë. Çështja e energjisë u diskutua gjithashtu dhe gjatë seancave parlamentare dhe në Komisionet parlamentare, për shkak të mos pagesës së të njëjtës nga ana e qytetarëve në veri dhe nevojës për mbulimin financiar të këtyre shpenzimeve. Gjithashtu dhe pyetjet që kishin të bënin me masat e reciprocitetit të cilat Lëvizja Vetëvendosje kishte thënë që do t'i vendoste sërish apo dhe çështja e asociacionit/bashkësinë së komunave me shumicë serbe.





## 2. Dialogu në komisionet parlamentare

Gjatë sesionit pranveror i cili filloi më 22 mars dhe përfundoi më 12 gusht të këtij viti, komisionet parlamentare mbajtën gjithsej 167 mbledhje. Temat e ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi u ngritën në 27 mbledhje, ku në shtatë prej tyre këto tema ishin si pika të rendit të ditës, ndërsa në 20 mbledhje tjera ato u diskutuan në kuadër të pikave tjera. Për dallim nga sesioni pranveror i legjislaturës së shtatë, këtë sesion komisionet e ngritën çështjen e dialogut në 10 mbledhje më shumë.

Komisionet që trajtuan më së shumti çështjen e dialogut ishin, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Komisioni për Integrim Evropian dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Ashtu si në legjislaturën e shtatë edhe gjatë këtij sesioni disa komisione nuk e ngritën çështjen e dialogut në asnjë nga mbledhjet e mbajtura. Në anën tjetër, disa nga komisionet i përfshinë çështjet e ndërlidhura me dialogun edhe **në planet e tyre të punës**, si Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni për Integrim Evropian, Komisioni për Arsimit, Komisioni për Ekonomi dhe Komisioni për Buxhet.<sup>8</sup>

Dy nga këto tema, dialogu në Uashington dhe çështja e shpenzimit të energjisë në veri ishin tema të diskutimit edhe në sesionin pranveror të legjislaturës së kaluar.

Lidhur me dialogun në komisione gjatë këtij sesioni raportoi tre herë Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog Besnik Bislimi, dhe një herë ministrja e ekonomisë Artane Rizvanolli. Ndërsa, kjo temë u ngrit edhe në kuadër të raportimeve të ministrave për çështje tjera në shtatë raste.

Një nga komisionet parlamentare, konkretisht ai për ekonomi realizoi dy vizita në terren për tu informuar nga afër lidhur me gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese të dialogut.

Komisionet mbajtën takimin e gjashtë koordinues gjatë këtij sesioni, me qëllim bashkërendimin dhe koordinimin për mbikëqyrjen e dialogut dhe marrëveshjeve. Takimi u kryesua nga kryetari i Kuvendit Glauk Konjufca.<sup>9</sup>



Temat kryesore të ndërlidhura me dialogun që u ngritën nga komisionet parlamentare gjatë këtij sesioni ishin, procesi i dialogut në përgjithësi, marrëveshja e 19 prillit, Asociacioni i komunave me shumicë serbe, marrëveshja/zotimet e Uashingtonit, energjia elektrike e shpenzuar në veri, kodi +383, integrimi i mbrojtjes civile dhe regjistrat kadastral.

<sup>8</sup> Në kuadër të asistencës për fuqizimin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj dialogut me Serbinë, KDI u ka rekomanduar të gjitha komisioneve në fillim të sesionit që të përfshijnë mbikëqyrjen e procesit të dialogut dhe marrëveshjeve të arritura, në bazë të fushëveprimit të tyre.

<sup>9</sup> Shih detajet e këtij takimi të mbështetur nga KDI në platformën Vota Ime, Moduli Dialogu Kosovë-Serbi në, <http://votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/516>



Në vijim janë paraqitur diskutimet rreth dialogut në të gjitha komisionet parlamentare:

## 2.1 Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

### Energjia elektrike e shpenzuar në veri ishte tema qendrore e diskutuar nga Komisioni për Ekonomi gjatë këtij sesioni.

Kjo çështje e ndërlidhur ngushtë me Marrëveshjen e Brukselit për Energji vazhdon të ketë implikime financiare për Kosovën. Komisioni e ngriti këtë temë në 12 nga 22 mbledhjet e mbajtura gjatë sesionit pranveror të këtij viti. Në pesë prej mbledhjeve tema e dialogut ishte si pikës e veçantë e rendit të ditës, ndërsa në shtatë mbledhje tjera ajo u ngrit në kuadër të pikave tjera. Konkretisht për këtë temë kishte një raportim të ministrave të qeverisë para komisionit. (Shih tabelën 2.1 dhe 2.2 në shtojcë) Vlen të theksohet se ky komision ka qenë komisioni më aktiv në diskutimet për dialogun edhe gjatë legjislaturës së shtatë.<sup>10</sup>

Fillimisht tema e dialogut u ngrit në mbledhjen e 20 prillit pasi komisioni kishte marrë një kërkesë nga kompania publike KOSTT, e cila kërkonte zgjidhje për mbulimin e humbjeve nga mos pagesa e energjisë elektrike në veri. Pas opinioneve të anëtarëve të komisioni lidhur me këtë problem, komisioni nxori një konkluzion me anë të të cilit vendosi që të ftojë në raportim ministren e ekonomisë, si dhe bordin e KOSTT.<sup>11</sup> Ky raportim u realizua në mbledhjen e 27 prillit dhe kryesuesi i KOSTT bashkë me ministren Artane Rizvanolli theksuan problemet që ka KOSTT me shtrirje dhe inkasim në pjesën veriore dhe gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme për këtë çështje. Po ashtu, anëtarët e komisionit kërkuan nga ministrja informacione nëse rritja e konsumit të energjisë në veri ishte si rezultat i veprimtarisë së kriptovalutave atje, gjë të cilën e pohoi ministrja. Anëtarët e komisionit kërkuan nga ministrja që qeveria të përmbush premtimin se nuk do të mbulojë më shpenzimet e energjisë të qytetarëve në veri, por do ti obligojë ata që të paguajnë energjinë. Në fund të debatit

komisioni miratoi një rekomandim për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në këtë pjesë të vendit nga ana e KOSTT dhe i njëjti u procedua Kuvendit për shqyrtim.<sup>12</sup> Me 22 qershor pati një raportim të dytë të KOSTT-it para komisionit me ç'rast u diskutua sërish çështja e energjisë në veri, në kuadër të shqyrtimit të Raportit vjetor të kësaj kompanie.<sup>13</sup>

Për të marrë informacione nga terreni për këtë çështje, kryetari i komisionit Ferat Shala dhe anëtarë nga radhët e opozitës Pal Lekaj realizuan një vizitë në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me 6 korrik 2021. Gjatë këtij takimi ata u informuan që sipas marrëveshjes së Brukselit për energji, kompania serbe Elektro Server tashmë ka plotësuar kushtet ligjore për t'u licencuar si furnizues, por vendimin përfundimtar duhet t'a marrë bordi i ZRRE-së, i cili nuk është ende funksional. Sidoqoftë, sipas zyrtarëve të ZRRE-së, edhe në rast të licencimit eventual të kësaj kompanie, shpërndarja, mirëmbajtja dhe qasja e KOSTT-it në pjesën veriore pritet të mbetet edhe më tutje sfidë.<sup>14</sup>

Çështja e energjisë u diskutua edhe në mbledhjet pasuese të komisionit bashkë me temën tjetër të ndërlidhur me dialogun, marrëveshjen e telekomunikacionit. Këto dy çështje u ngritën në mbledhjen e datës 13 korrik dhe 15 korrik, ku raportuan ministrja Artane Rizvanolli dhe përfaqësuesit e ARKEP-it. Ministrja u pyet për çështjet e energjisë që dalin nga zotimet e Uashingtonit, për të cilat ajo tha se për këtë tashmë ishte përgjigjur qeveria në debatin parlamentar të mbajtur me 7 korrik. Ndërsa, lidhur me telekomin kryetari i bordit të ARKEP-it e njoftoi komisionin se **Telekomi i Kosovës ende nuk ka arritur të zbatojë kodin +383 dhe për këtë është gjobitur nga ARKEP 5 mijë euro në muaj** dhe se kjo gjobë do të vazhdojë çdo muaj derisa Telekom i Kosovës ta përmbyllë implementimin e kodit.<sup>15</sup> Anëtarët e komisionit u interesuan edhe lidhur me operimin dhe monitorimin e kompanisë serbe të telefonisë MTS, për të cilën çështje përfaqësuesit e ARKEP thanë se do të përgjigjen me shkrim.<sup>16</sup>

10 Shih raportin e KDI-së Dialogu Kosovë-Serbi gjatë legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës në, <https://kdi-kosova.org/publikimet/dialogu-kosove-serbi-gjate-legjislatures-se-shtate-te-kuvendit-te-kosoves/>

11 Shih mbledhjen e datës 20 prill 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_02\\_dt\\_20\\_04\\_2021\\_KEINT\\_nBk8GJ4szd.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_02_dt_20_04_2021_KEINT_nBk8GJ4szd.pdf)

12 Shih mbledhjet e datës 27 dhe 28 prill 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_03\\_dt\\_27\\_28\\_04\\_2021\\_KEINT\\_3q6xWfEzm4.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_03_dt_27_28_04_2021_KEINT_3q6xWfEzm4.pdf)

13 Shih mbledhjen e datës 22 qershor 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Procesverbal22.06.2021\\_LjcaLeyBRA.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Procesverbal22.06.2021_LjcaLeyBRA.pdf)

14 Shih detajet e kësaj vizite në platformën e KDI-së Vota Ime në, <http://www.votaimo.org/Public/DialogActivity/Detail/528>

15 Shih mbledhjen e datës 13 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_13\\_dt\\_13\\_07\\_2021\\_KEINT\\_4PDEuwnXvd.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_13_dt_13_07_2021_KEINT_4PDEuwnXvd.pdf)

16 Shih mbledhjen e datës 15 korrik 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_15\\_dt\\_15\\_07\\_2021\\_KEINT\\_jLkhNdYe85.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_15_dt_15_07_2021_KEINT_jLkhNdYe85.pdf)

Lidhur me çështjet e ndërlidhura me telekomin përfaqësues të komisionit realizuan edhe një vizitë në terren në ARKEP me 29 korrik. Arsyeja e vizitës ishte informimi nga afër lidhur me disa mesazhe roaming që u janë dërguar qytetarëve në rrethinë të Manastirit të Deçanit. Sipas ARKEP-it kjo ka ndodhur si pasojë e një lëshimi teknik nga Telekom Serbia dhe humbjes së sinjalit nga rrjeti amë i konsumatorëve të IPKO-s, ku këta të fundit janë lokalizuar në roaming. Po ashtu, ARKEP shtoi se meszhet nuk i ka dërguar kompania serbe MTS, por IPKO konsumatorëve të vet pasi ata janë lokalizuar në roaming në një shtet të huaj.<sup>17</sup> Ndërsa kjo dukuri tanimë është ndërprerë pas bisedave që ARKEP ka realizuar me IPKO-në. Anëtarët e komisionit u interesuan edhe lidhur me obligimet që ka operatori MTS, në zbatim të Marrëveshjes së Brukselit për telekomin. Lidhur me këtë, ARKEP e njoftoi komisionin se janë duke e monitoruar operatorin MTS dhe për pikat ku nuk e ka zbatuar marrëveshjen ajo është sanksionuar nga ARKEP.<sup>18</sup>

Në mbledhjet e tjera ku u diskutuan çështjet e ndërlidhura me dialogun, u përmend shkurtimisht edhe miniera Trepça dhe kripovalutat në veri që kishin rritur konsumin e energjisë në këtë pjesë të vendit.<sup>19</sup>

## 2.2 Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë

Ky komision e trajtoi çështjen e dialogut me Serbinë në katër nga gjashtë mbledhjet e mbajtura gjatë sesionit pranveror. Një ritëm të ngjashëm të diskutimeve rreth dialogut ky komision e ka pasur edhe në sesionin pranveror të legjislaturës së shtatë.<sup>20</sup>

Në një prej mbledhjeve gjatë këtij sesioni dialogu ishte pikë e veçantë e rendit të ditës, ndërsa në tri tjera u diskutua në kuadër të pikave tjera. Para komisionit kishte një raportim nga ana e Qeverisë, konkretisht nga zëvendëskryeministri Besnik Bislimi (Shih tabelën 2.1 dhe 2.3 në shtojcë). Kjo temë u parapa edhe në planin e punës të komisionit me fokus në raportimin e përfaqësuesve të qeverisë,

anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe procesin e çnjohjeve nga Serbia.

**Rreth një muaj pas konstituimit të komisionit, konkretisht në mbledhjen e 5 majit 2021, komisioni ftoi në raportim zëvendëskryeministrin e parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi,** lidhur me një vizitë në Bruksel që ishte realizuar me 27-29 prill 2021, temë e së cilës kishte qenë kryesisht dialogu Kosovë-Serbi.<sup>21</sup>

Diskutimi në komision u karakterizua me polemika mes Bislimit dhe anëtarëve nga radhët e opozitës. Si pikë të parët gjatë diskutimit Bislimi kishte theksuar faktin që si qeveri kishin marrë informacione të pakta lidhur me dialogun nga qeveritë paraprake. Rrjedhimisht kjo ishte arsyeja e vizitës në Bruksel, për tu informuar lidhur me zhvillimet në këtë proces nën udhëheqjen e qeverive të kaluara.

Anëtarët e komisionit shprehën interesim për tu informuar lidhur me planet e qeverisë për dialogun, takimin e rrodhes me Serbinë, temat e diskutimit, parimet mbi të cilat do të udhëhiqej ky proces si dhe përfshirjen e SHBA-ve. Në pyetjet e komisionit Bislimi në vija të trasha i njoftoi anëtarët lidhur me parimet e dialogimit me Serbinë, ndërsa kërkoi që detajet tjera mbi procesin dhe temat të diskutohen me dyer të mbyllura, gjë për të cilën komisioni u pajtua.

Përveç kësaj, anëtarët e komisionit e pyetën Bislimin edhe për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, duke iu referuar deklaratave të përfaqësuesve evropian. Lidhur me këtë çështje Bislimi i njoftoi anëtarët se në takimet në Bruksel vetëm ishin cekur marrëveshja e 19 Prillit dhe e 25 Gushtit që kanë të bëjnë me Asociacionin dhe se nuk ishte biseduar lidhur me kompetencat e tij. Në fund, Bislimi iu përgjigj pozitivisht kërkesës së anëtarëve të komisionit që platforma për dialogun të bëhet me debat të gjerë dhe gjithëpërfshirje.<sup>22</sup>

17 Shih detajet e kësaj vizite në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/komisioni-per-ekonomi-vizitoi-autoritetin-rre-27719/>

18 Po aty.

19 Shih mbledhjen dhe dëgjimin publik të datës 4 gusht 2021 në [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_20\\_dt\\_04\\_08\\_2021\\_KEINT\\_5qgwEVkpgL.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_20_dt_04_08_2021_KEINT_5qgwEVkpgL.pdf) dhe [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/2021\\_08\\_08\\_TRANSKRIPTNGADEGJIMIPUBLIKnismalegjislativPLKriptovaluta4gusht2021\\_LJB5gUP4a8.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/2021_08_08_TRANSKRIPTNGADEGJIMIPUBLIKnismalegjislativPLKriptovaluta4gusht2021_LJB5gUP4a8.pdf)

20 Shih raportin e KDI-së Dialogu Kosovë-Serbi gjatë legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës në, <https://kdi-kosova.org/publikimet/dialogu-kosove-serbi-gjate-legjislatures-se-shtate-te-kuvendit-te-kosoves/>

21 Shih mbledhjen e datës 5 maj 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_02\\_dt\\_05\\_05\\_2021\\_KPJD\\_9BGDNJXdmd.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_02_dt_05_05_2021_KPJD_9BGDNJXdmd.pdf)

22 Po aty.

Disa javë pas raportimit të Bislimit, komisioni me 25 maj ftoi edhe ministren e jashtme Donika Gërvalla-Schwarz. Edhe pse arsyeja e ftesës në raportim ishte plani legjislativ i Ministrisë dhe prioritetet e saj, gjatë diskutimit u ngrit edhe çështja e dialogut me Serbinë. Lidhur me këtë temë, nga anëtarët opozitar ministria Gërvalla u pyet se si e shihte rolin e MPJ-së në procesin e dialogut, në të cilën ajo u përgjigj se ka qenë e përfshirë në të gjithë hapat që janë ndërmarrë në dialog deri më tani. Duke përfshirë edhe takimet në Bruksel, dhe sipas saj ka partneritet dhe koordinim shumë të mirë në mes institucioneve përgjegjëse në politikën e jashtme dhe vullnet për tu koordinuar me Kuvendin.<sup>23</sup> Ajo theksoi se kjo qeveri nuk do ti ik dialogut pasi të gjitha argumentet janë në anën e Kosovës. Ministria u pyet edhe lidhur me qëndrimet e qeverisë për çështje si marrëveshja e 19 Prillit, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me asociacionin, pyetje këto në të cilat ministria deklaroi që do të përgjigjet në ndonjë diskutim tjetër.

Tema e dialogut u ngrit nga anëtarët e komisionit edhe në një takim që komisioni pati me një delegacion nga Parlamenti i Austrisë me 3 qershor. Gjatë diskutimit anëtarët opozitar njoftuan delegacionin lidhur me procesin e dialogut, duke vënë theksin tek rëndësia që ka përmbyllja e këtij procesi për stabilitetin rajonal. Ky mendim u nda edhe nga ana e delegacionit austriak.<sup>24</sup>

Mbledhja e fundit e komisionit për punë të jashtme në të cilën u ngrit çështja e dialogut ishte ajo e datës 15 qershor. Në kuadër të pikës së rendit të ditës 'plani për mbikëqyrjen e procesit integruar 2020-2021 dhe inkuadrimi i të gjeturave në planin e punës', komisioni diskutoi Raportin për Kosovën dhe nxorri një përfundim dypikësh lidhur me dialogun. Me anë të tij komisioni u zotua që të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e MPJ-së dhe Zyrës së Kryeministrit, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dalta nga Raporti për Kosovën lidhur me dialogun.<sup>25</sup>

## 2.3 Komisioni për Integrim Evropian

Ky komision i ngriti çështjet e ndërlidhura me dialogun me Serbinë në katër nga tetë mbledhjet e mbajtura gjatë sesionit pranveror, për dallim nga legjislatura e shtatë kur nuk e kishte ngritur fare këtë temë. Në një nga mbledhjet dialogu ishte pjesë e rendit të ditës, ndërsa në tri mbledhje u diskutua në kuadër të pikave tjera. Tema e dialogut u ngrit gjatë dy raportimeve të zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi para këtij komisioni. (Shih tabelën 2.1 dhe 2.4 në shtojcë). Raportimi i tij ishte i përfshirë edhe në planin vjetor të punës së komisionit.

Për herë të parë tema e dialogut u ngrit në mbledhjen e mbajtur me 12 maj, në takimin që komisioni pati me Tomáš Szunyog, shef i Zyrës së BE-së dhe Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë. Ai shprehu mbështetjen e BE-së për dialogun ndërsa kërkoi nga Kuvendi mbikëqyrje efektive të qeverisë në këtë proces. Në anën tjetër anëtarët e komisionit kërkuan që BE-ja të trajtojë Kosovën si të barabartë në dialog dhe marrëveshjet të respektojnë rendin e brendshëm kushtetues, me theks marrëveshja e Asociacionit.<sup>26</sup>

Rreth një muaj pas këtij takimi komisioni e ftoi në raportim Besnik Bislimin, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog. Edhe pse arsyeja e ftesës ishte procesi integruar i Kosovës, gjatë diskutimit u ngrit edhe tema e dialogut. Kjo sepse anëtarët e opozitës insistuan që të diskutohet edhe kjo çështje pasi vlerësuan se dialogu lidhet ngushtë me proceset integruar të Kosovës. Lidhur me këtë opozita kritikoi qeverinë për mungesë të transparencës në dialog, në të cilën Bislimi u përgjigj se ata kishin njoftuar gjithë akterët politik me zhvillimet në takimet e Brukselit.<sup>27</sup>

Dialogu u ngrit sërish në raportimin e dytë të Bislimit para komisionit me 14 korrik, kur ai u ftua lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare për IPA 2020". Edhe gjatë këtij takimi anëtarët e komisionit

<sup>23</sup> Shih mbledhjen e datës 25 maj 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_03\\_dt\\_25\\_05\\_2021\\_KPJD\\_TdvEnmJEMM.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_03_dt_25_05_2021_KPJD_TdvEnmJEMM.pdf)

<sup>24</sup> Shih mbledhjen e datës 3 qershor 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_04\\_dt\\_03\\_06\\_2021\\_KPJD\\_DkrmWL9K9w.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_04_dt_03_06_2021_KPJD_DkrmWL9K9w.pdf)

<sup>25</sup> Përfundim: 1. Kosova të vazhdojë të zhvillojë raporte të mira fqinjësore dhe të jetë pjesë aktive e bashkëpunimit rajonal; 2. Kosova të ndërmarrë hapa drejtë arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme, për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe njohjen e dyanshme. Shih mbledhjen e datës 15 qershor 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_05\\_dt\\_15\\_06\\_2021\\_KPJD\\_nuUnjzDJ6.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_05_dt_15_06_2021_KPJD_nuUnjzDJ6.pdf)

<sup>26</sup> Shih mbledhjen e datës 12 maj 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_02\\_dt\\_12\\_05\\_2021\\_KIE\\_YsJwHq6Nsr.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_02_dt_12_05_2021_KIE_YsJwHq6Nsr.pdf)

<sup>27</sup> Shih mbledhjen e datës 2 qershor 2021 në [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_04\\_dt\\_02\\_06\\_2021\\_KIE\\_Wn9Fbq8qXh.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_04_dt_02_06_2021_KIE_Wn9Fbq8qXh.pdf)



shprehën interesim për të kuptuar lidhur me zhvillimet rreth dialogut, sidomos që tanimë veç ishte zhvilluar një takim mes kryeministrit Kurti e Presidentit Vuçiq me 15 qershor dhe i radhës pritej të mbahej me 19 korrik. Anëtarët e komisionit e pyeten zëvendëskryeministrin Bislimi se çfarë ishte diskutuar në takimin e qershorit dhe cila do të jetë strategjia dhe platforma e qeverisë në takimin e korrikut. Në këtë pyetje përgjigja e Bislimit ishte se lidhur me takimin në qershor ai tashmë i kishte njoftuar deputetët, komisionin për punë të jashtme, liderët politik dhe institucionet përkatëse, ndërsa shtoi se qeveria nuk do ta bëjë publike strategjinë për dialog në mënyrë që ajo të mos kuptohet nga pala serbe.<sup>28</sup>

Çështjet e ndërlidhura me dialogun u ngritën edhe në mbledhjen e 16 qershorit kur në raportim para komisionit u ftua ministria e Drejtësisë Albulena Haxhiu. Kjo e fundit e theksoi qasjen e re të qeverisë në dialog, ndërsa ftoi deputetët që të ushtrjnë rolin e tyre mbikëqyrës ndaj këtij procesi me anë të mekanizmave parlamentar në dispozicion.<sup>29</sup> Në anën tjetër, anëtarët e komisionit kritikuan qeverinë për mungesë të konsistencës ndaj dialogut me theks tek marrëveshja për fusnotën. Ndaj kësaj kritike ministria u përgjigj se fusnota ishte pranuar nga pushteti i kaluar dhe se tani nevojitet përkushtim nga të gjitha institucionet për të eliminuar gabimet e së kaluarës.<sup>30</sup>

## 2.4 Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Edhe komisioni për mbikëqyrjen e financave publike ishte një nga komisionet që e ngriti çështjen e dialogut me Serbinë gjatë sesionit pranveror, për dallim nga legjislatura e shtatë kur nuk kishte diskutuar për këtë temë në asnjë mbledhje.

Gjatë këtij sesioni, ky komision e trajtoi temën e dialogut në tri nga 18 mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe

(Shih tabelën 2.1 dhe 2.5 në shtojcë). **Fokus i këtyre diskutimeve ishte çështja e integritit të strukturave të sigurisë në institucionet e Kosovës.** Komisioni diskutoi lidhur me këtë temë në mbledhjen e 6 korrikut në kuadër të pikës së rendit të ditës 'Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2020', ku e ftuar ishte edhe ministria e Tregtisë Rozeta Hajdari. Një nga anëtarët e komisionit nga radhët e pozitës theksoi një nga të gjeturat e zyrës së auditorit lidhur me Marrëveshjen e Brukselit për integrimin e 'Mbrojtjes Civile'.<sup>31</sup> Sipas tij, **MTI ka të angazhuar 25 punonjës të komunitetit serb, mirëpo të njëjtit nuk kanë dalë në punë në MTI që nga viti 2016, kur janë nënshkruar aktemërimet e tyre.** Shpenzimi buxhetor për pagat e këtyre të punësuarve për vitin 2020 ishte 122,738€. Ndërsa që nga viti 2016 shuma është në total rreth 600,000 euro. Përgjigja e ministres Hajdari ishte se ministria e saj i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme edhe në të kaluarën për të gjetur lokacionin e këtyre punonjësve. Deri më tani ajo kishte takuar vetëm dy nga këta punonjës që ishin shprehur të gatshëm që të punojnë në MTI.<sup>32</sup>

Komisioni e ngriti këtë çështje edhe në mbledhjen e datës 13 korrik kur të ftuar në raportim kishte ministrin e Administratës dhe Pushtetit Lokal Elbert Krasniqin, për të raportuar lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë. Anëtarët e komisionit kërkuan sqarime se pse në raport nuk figuronte pagesa e punonjësve që nuk e kanë vijuar punën, sidomos në veri, gjë për të cilën ministri nuk u përgjigj.<sup>33</sup>

Komisioni e shqyrtoi këtë çështje edhe në mbledhjen e 21 korrikut, në kuadër të shqyrtimit të raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020, ku i ftuar ishte ministri Xhelal Sveçla.<sup>34</sup> Anëtarët e komisionit e pyetën ministrin lidhur me pagat për punonjësit serb që nuk kishin dalë në punë dhe kërkuan nga qeveria që mos të vazhdojë kjo praktikë.

28 Shih mbledhjen e datës 14 korrik 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_06\\_dt\\_14\\_07\\_2021\\_KIE\\_KdSPT6chXR.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_06_dt_14_07_2021_KIE_KdSPT6chXR.pdf)

29 Shih mbledhjen e datës 16 qershor 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_05\\_dt\\_16\\_06\\_2021\\_KIE\\_XABVav3aFq.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_05_dt_16_06_2021_KIE_XABVav3aFq.pdf)

30 Po aty.

31 Shih mbledhjen e datës 6 korrik 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_12\\_dt\\_06\\_07\\_2021\\_KMFP\\_5gnMkKqmAa.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_12_dt_06_07_2021_KMFP_5gnMkKqmAa.pdf)

32 Po aty.

33 Shih mbledhjen e datës 13 korrik 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_13\\_dt\\_13\\_07\\_2021\\_KMFP\\_28H9mtnkrW.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_13_dt_13_07_2021_KMFP_28H9mtnkrW.pdf)

34 Shih mbledhjen e datës 21 korrik 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_14\\_dt\\_21\\_07\\_2021\\_KMFP\\_Cq5S9Af4ND.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_14_dt_21_07_2021_KMFP_Cq5S9Af4ND.pdf)





dhe Sport, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, Komision për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione. Prej tyre, Komisioni për Arsim e ka të përfshirë mbikëqyrjen e marrëveshjeve të dialogut në planin vjetor të punës, prandaj pritet që ky komision do të trajtojë këtë çështje në sesionin tjetër.

**2.6.1 Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere:** Ky komision e trajtoi dialogun në një nga mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe.<sup>41</sup> Konkretisht kryetari i komisionit Armend Muja i njoftoi anëtarët e komisionit se në plan të punës janë paraparë vizita studimore në pikat doganore, si dhe raportimi i zyrtarëve përgjegjës të Fondit për veriu.<sup>42</sup>

**2.6.2 Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë:** Edhe komisioni për bujqësi e trajtoi dialogun në një nga mbledhjet e mbajtura. Në mbledhjen e datës 1 qershor u përmend marrëveshja/zotimet e 4 shtatorit 2020 të arritura në Uashington mes Kosovës dhe Serbisë.<sup>43</sup> Në kudër të shqyrtimit të raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2020, anëtari i bordit Gëzim Qerimi përmendi hekurudhën Durrës- Prishtinë, për të cilën ai tha se vjen nga procesi i Berlinit dhe ka vazhduar me marrëveshjen e Uashingtonit. Sipas tij në tetor janë zotuar për një studim të fizibilitetit, i cili është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës.

## 2.7 Takimi i gjashtë koordinues mes komisioneve parlamentare

Gjatë këtij sesioni kryetarët e komisioneve parlamentare kanë mbajtur takimin e gjashtë koordinues, i cili u kryesua nga kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca. Në këtë takim u kërkuar sqarime të statusit juridik të secilës marrëveshje të dialogut dhe rivlerësim të tyre, por edhe ripozicionim mbi fazën e re të dialogut, me qëllim të mundësimit të një mbikëqyrje edhe më efektive të Kuvendit. Po ashtu, kryetarët e komisioneve, shprehën vullnetin për bashkëpunim të mëtutjeshëm, si dhe vullnetin për të vazhduar me aktivitete mbikëqyrëse edhe në të ardhmen.

Që nga vitit 2016, janë mbajtur edhe pesë takime të tilla mes komisioneve gjatë legjislaturave të kaluara, të cilat kanë për qëllim fuqizimin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe çështjeve të ndërlidhura me të.<sup>44</sup> Në secilin takim përfaqësuesit e komisioneve kanë shprehur përkushtimin e tyre për të qenë më aktiv në mbikëqyrjen e dialogut dhe marrëveshjeve të arritura. Disa nga komisionet i kanë përmbushur këto zotime, ndërsa disa tjera nuk janë treguar proaktive në mbikëqyrjen e këtij procesi dhe derivateve të tij edhe pse kjo temë bie në fushëveprimet e pthuhajse të gjitha komisioneve.

41 Po aty.

42 Shih mbledhjen e datës 28 maj 2021 në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/komisioni-per-buxhet-pune-dhe-transfere-mirat-27039/>

43 Shih mbledhjen e datës 1 qershor 2021 në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc\\_nr\\_08\\_dt\\_01\\_06\\_2021\\_KBPM\\_VCmHv4gYBe.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_08_dt_01_06_2021_KBPM_VCmHv4gYBe.pdf)

44 Po aty.





# Përfundime dhe rekomandime

Dialogu si çështje është trajtuar – si pikë e veçantë e rendit të ditës apo vetëm si diskutim – në 18 prej gjithsej 23 seanca të mbajtura prej të cilave 16 ishin të rregullta, katër të jashtëzakonshme dhe dy solemne.

Çështja që ndërlidhen me procesin e dialogut në përgjithësi u trajtuan gjatë periudhës së deklaramëve jashtë rendit të ditës, apo pikave tjera që nuk trajton drejtpërdrejtë çështjen e dialogut. Si pikë e rendit të ditës, dialogu ka qenë pjesë në vetëm 22% të të gjitha seancave, përkatësisht në katër nga 18 seancat ku është trajtuar dialogu. Krahasuar me legjislaturën e kaluar, ka një ulje të ndjeshme të kësaj çështjeje si pjesë e rendit të ditës. Ndërsa, në 14 raste të tjera, dialogu është trajtuar vetëm si çështje në mesin e diskutimeve që janë zhvilluar lidhur me çështje të caktuara.

Përkundër kuadrin relativisht të konsoliduar që ofrohet nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për mbikëqyrjen parlamentare, gjatë këtij sesioni deputetët nuk kanë ushtruar efektivisht dhe në masë të duhur mekanizmat në dispozicion për mbikëqyrje. Përgjithësisht, mekanizmat e mbajtjes e ekzekutivit llogaridhënës në raport me dialogun ishin interpelancat, debatet parlamentare, raportimet e kryeministrit dhe pyetjet parlamentare.

Gjatë sesionit pranveror të legjislaturës së tetë, nuk pati asnjë interpelancë të veçantë të iniciuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës qoftë nga radhët e pozitës apo opozitës lidhur me procesin e dialogut.

Gjatë sesionit pranveror të legjislaturës së tetë janë mbajtur gjithsej gjashtë debate parlamentare, ndër të cilat çështja e dialogut ishte pjesë e dy prej tyre. Njëri prej debateve parlamentare ishte drejtpërdrejt i lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit, ndërsa tjetri debat parlamentar ishte ftuar lidhur me punën 100 ditore të Qeverisë së Kosovës, në kuadër të së cilës pashmangshëm u trajtua edhe çështja e dialogut dhe temat e ndërlidhura me të.

Gjatë këtij sesioni pranveror të kësaj legjislature ka pasur vetëm një elaborim të çështjes së dialogut në formë të diskutimit nga Kryeministri. Ndërsa, 39 deputet të Kuvendit kanë parashtruar gjithsej 108 pyetje parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar. Nga numri i përgjithshëm i pyetjeve parlamentare, 13 prej tyre kishin në fokus çështjet që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi, apo 12% të tyre. Krahasuar me tërë legjislaturën e shtatë, mund të thuhet që ka një ngritje në numrin e pyetjeve të parashtruara nga deputetët ku në atë parapraken ishin vetëm shtatë pyetje apo vetëm 4% e tyre lidhur me çështjen e dialogut.

Gjatë sesionit pranveror i cili filloi me 22 mars dhe përfundoi me 12 gusht të këtij viti, komisionet parlamentare mbajtën gjithsej 167 mbledhje. Temat e ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi u ngritën në 27 mbledhje, ku në shtatë prej tyre këto tema ishin si pika të rendit të ditës, ndërsa në 20 mbledhje tjera ato u diskutuan në kuadër të pikave tjera. Për dallim nga sesioni pranveror i legjislaturës së shtatë, këtë sesion komisionet e ngritën çështjen e dialogut në 10 mbledhje më shumë.

Temat kryesore të ndërlidhura me dialogun që u ngritën nga komisionet parlamentare gjatë këtij sesioni ishin, procesi i dialogut në përgjithësi, marrëveshja e 19 prillit, Asociacioni i komunave me shumicë serbe, marrëveshja/zotimet e Uashingtonit, energjia elektrike e shpenzuar në veri, kodi +383, integrimi i mbrojtjes civile dhe regjistrat kadastral. Dy nga këto tema, dialogu në Uashington dhe çështja e shpenzimit të energjisë në veri ishin tema të diskutimit edhe në sesionin pranveror të legjislaturës së kaluar.

Lidhur me dialogun në komisione gjatë këtij sesioni raportoi tre herë Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog Besnik Bislimi, dhe një herë ministrja e ekonomisë Artane Rizvanolli. Ndërsa, kjo temë u ngrit edhe në kuadër të raportimeve të ministrave për çështje tjera në shtatë raste.





Një nga komisionet, konkretisht ai për ekonomi realizoi dy vizita në terren për tu informuar nga afër lidhur me gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese të dialogut.

Komisionet mbajtën takimin e gjashtë koordinues gjatë këtij sesioni, me qëllim bashkërendimin dhe koordinimin për mbikëqyrjen e dialogut dhe marrëveshjeve. Takimi u kryesua nga kryetari i Kuvendit Glauk Konjufca.<sup>45</sup>

Duke pasur parasysh aktivitetin e Kuvendit në mbikëqyrje të procesit të dialogut gjatë këtij sesioni, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme me qëllim që Kuvendi të fuqizojë më tutje mbikëqyrjen parlamentare ndaj dialogut gjatë sesioni vjeshtor:

- Deputetët e Kuvendit duhet të shfrytëzojnë më shumë mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare në dispozicion, duke parashtruar më shumë pyetje parlamentare, duke organizuar më shumë debate dhe interpelanca ndaj përfaqësuesve të qeverisë lidhur me çështjen e dialogut.
- Kuvendi duhet të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie të procesit të dialogut duke ftuar në raportim kryeministrin dhe ministrat në seanca dhe në komisione, lidhur me çështjen e dialogut në përgjithësi dhe temat specifike në veçanti.
- Deputetët individualisht dhe në kuadër të komisioneve duhet të organizojnë më shumë vizita në terren për të parë nga afër efektet e dialogut në jetën e qytetarëve dhe gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të dialogut në terren.
- Komisionet duhet të përfshijnë në planet e punës mbikëqyrjen e temave dhe marrëveshjeve të dialogut që bien në fushëveprimin e tyre.

- Komisionet duhet të organizojnë diskutime publike për procesin e dialogut në përgjithësi dhe për tema të veçanta rreth dialogut që bien në fushëveprimin e komisioneve.
- Komisionet duhet të shfrytëzojnë ekspertizën e brendshme të Kuvendit dhe atë të jashtme për të marrë më shumë informacione lidhur me temat e dialogut.
- Komisionet duhet të vazhdojnë praktikën e organizimit të mbledhjeve të përbashkëta me qëllim bashkërendimin dhe koordinimin e mbikëqyrjeve të procesit të dialogut dhe marrëveshjeve të arritura në kuadër të këtij procesi.

<sup>45</sup> Shih detajet e këtij takimi të mbështetur nga KDI në platformën Vota Ime, Moduli Dialogu Kosovë-Serbi në, <http://votaim.org/Public/DialogActivity/Detail/516>



# SHTOJCË

## Dialogu në Seanca gjatë sesionit pranveror të Legjislaturës së Tetë

**Tabela 1.1: Dialogu në Seancat e sesionit pranveror të Legjislaturës së tetë (mars - gusht 2021)**

Nr.	Data	Seanca	Rend Dite/ Diskutim	Pikat	Çështjet e Diskutimit
1	22 mars 2021	E veçantë	Diskutim	Zgjedhja e Qeverisë	U përmend edhe dialogu me Serbinë
2	4 prill 2021	E veçantë	Diskutim	Zgjedhja e Presidentit	Dialogu në përgjithësi
3	26 prill 2021	Plenare	Diskutim	Në kuadër të pikave tjera të rendit të ditës	Dialogu në përgjithësi
4	6 maj 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare	Takimi i Brukselit dhe marrëveshjet e kaluara
			Rend Dite	Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në lidhje me kërkesën e NP KOSTT për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës.	Energjia elektrike në veri
5	17 maj 2021	E jashtëzakonshme	Diskutim	Prezantimi i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025	Dialogu në përgjithësi
6	20 maj 2021	Plenare	Diskutim	Interpelancë me ministrin e Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati, në lidhje me "Uljen e shtesave të pensionistëve, stafit shëndetësor dhe institucioneve të sigurisë",	Çështja e fondit pensional të marrë nga Serbia
7	27 maj 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare	Reciprociteti me Serbinë, Dialogu me serbët lokal;
8	3 qershor 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare	Takimi i qershorit Kurti- Vuçiq, platforma për dialogun;

|||||

<b>9</b>	11 qershor 2021	Plenare	Rend Dite	Diskutim mbi ecurinë e deritanishme të procesit të dialogut me Serbinë	Raporti i gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të kaluara.
<b>10</b>	17 qershor 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës	Cështja e përfaqësimit të Kosovës në mekanizma rajonal
<b>11</b>	22 qershor 2021	E veçantë	Diskutim	Adresimi i ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, Luigi Di Maio	Dialogu në përgjithësi
<b>12</b>	24 qershor 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare	Marrëveshja e Uashingtonit, energjia elektrike në veri, Asociacioni;
<b>13</b>	7 korrik 2021	Plenare	Rend dite	Debat parlamentar për zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit	Marrëveshja e Uashingtonit;
<b>14</b>	22 korrik 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare	Dialogu në përgjithësi
<b>15</b>	2 gusht 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare  Debat parlamentar lidhur me punën 100-ditore të Qeverisë së Republikës së Kosovës	Dialogu në përgjithësi dhe reciprociteti;  Mungesëa e platformës dhe llogaridhënies në dialogun me Serbinë;
<b>16</b>	3 gusht 2021	vazhdimi seancës plenare	Diskutim	Vazhdim i debatit parlamentar lidhur me punën 100-ditore të Qeverisë së Republikës së Kosovës	Dialogu në përgjithësi;
<b>17</b>	6 gusht 2021	Plenare	Diskutim	Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare  Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e drejtorëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit	Cështja e largimit të masës mbrojtëse ndaj produkteve ndërtimore që vijnë nga Serbia; Strukturat paralele;  Cështja e Trepçës dhe mbrojtjes së saj nga pretendimet e Serbisë;
<b>18</b>	12 gusht 2021	vazhdim i seancës plenare	Rend Dite	Shqyrtimi i raportit me rekomandime lidhur me problemet e evidentuara në NP KOSTT sh. a.	Energjia elektrike në veri;

|||||





|||||

## Dialogu në komisione parlamentare gjatë sesionit pranveror të Legjislaturës së Tetë

**Tabela 2.1: Dialogu në komisionet parlamentare gjatë sesionit pranveror (mars - gusht 2021)**

Komisionet e Kuvendit	Numri i mbledhjeve	Dialogu si pikë e rendit të ditës	Dialogu në kuadër të pikave tjera të rendit të ditës	Raportime të Qeverisë për Dialogun
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere	19	0	1	0
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim	6	0	0	0
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	14	0	2	0
Komisioni për Integrim Evropian	8	1	3	1
Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë	6	1	3	1
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport	12	0	0	0
Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti	22	5	7	1
Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë	16	0	1	0
Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	11	0	0	0
Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal	9	0	0	0
Komision për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes	10	0	0	0
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione	16	0	0	0
Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	18	0	3	0
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë*	/	/	/	/
<b>Gjithsej</b>	<b>167</b>	<b>7</b>	<b>20</b>	<b>3</b>

\*Për arsye se mbledhjet e këtij komisioni janë të mbyllura, ky komision nuk do të jetë subjekt i raportit

|||||

|||||

**Tabela 2.2: Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, gjatë sesionit pranveror (mars - gusht 2021)**

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	20 prill 2021	Diskutim	Shqyrtimi i kërkesave	Marrëveshja për energji
2	27 prill 2021	Rend dite	Raportim i NP KOSTT dhe ministres së Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli, lidhur me kërkesën e KOSTT	Marrëveshja për energji
3	28 prill 2021	Diskutim	Raportimi i ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli	Marrëveshja për energji
4	15 qershor 2021	Diskutim	Raportimi ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, lidhur me planin e Ministrisë për vitin 2021	Reciprociteti me Serbinë
5	22 qershor 2021	Rend Dite	Shqyrtimi i Raportit vjetor të KOSTT SH.A, për vitin 2020	Marrëveshja për energji
6	6 korrik 2021	Vizitë në terren	Takim me ZRRE	Marrëveshja për energji
7	13 korrik 2021	Diskutim	1. Shqyrtimi i Raportit vjetor të ARKEP, për vitin 2020 2. Raportim i ministres, znj. Artane Rizvanolli, për planin e Ministrisë së Ekonomisë, për vitin 2021	1. Marrëveshja e Telekomunikacionit, 2. Marrëveshja e Energjisë
8	15 korrik 2021	Diskutim	Shqyrtimi i Raportit vjetor të ARKEP, për vitin 2020	Marrëveshja e Telekomunikacionit dhe Marrëveshja e Energjisë
9	19 korrik 2021	Rend dite	Kthimi i Përgjigjes për Gjykatën Kushtetuese lidhur me rastin K093/21	Mbulimi i shpenzimeve të energjisë në veri
10	29 korrik 2021	Vizitë në terren	Takim me ARKEP	Marrëveshja e Telekomunikacionit
11	4 gusht 2021	Diskutim	Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë, për emërimin e Bordit të AKP-së	Trepça
12	4 gusht 2021	Diskutim	Hartimi i nismës legislative 'Projektligji për kriptovalutat'	Shpenzimi i energjisë në veri

**Tabela 2.3: Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, gjatë sesionit pranveror (mars - gusht 2021)**

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	5 maj 2021	Rend Dite	Raportim i zëvendëskryeministrit të parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi lidhur me vizitën në Bruksel	Procesi i dialogut në përgjithësi
2	25 maj 2021	Diskutim	Raportim i Ministres së Jashtme Donika Gërvalla-Schwarz	Roli i MPJ-së në dialog dhe Asociacioni
3	3 qershor 2021	Diskutim	Takim me delegacionin nga Parlamenti i Austrisë	Procesi i dialogut në përgjithësi
4	15 qershor 2021	Diskutim	Plani për mbikëqyrjen e procesit integruar 2020-2021 dhe inkuadrimi i të gjeturave në planin e punës së komisionit	Raporti i vendit, kapitulli për dialogun

|||||

|||||

**Tabela 2.4: Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Integrim Evropian, gjatë sesionit pranveror (mars - gusht 2021)**

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	12 maj 2021	Diskutim	Takim me shefin e Zyrës dhe Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë, Tomáš Szunyog	Dialogu në përgjithësi dhe Asociacioni
2	2 qershor 2021	Rend Dite	Raportimi i Besnik Bislimi, zv/ kryeministër i parë për integrim evropian, zhvillim dhe dialog	Dialogu në përgjithësi
3	16 qershor 2021	Diskutim	Raportimi i znj. Albulena Haxhiu, ministre e Ministrisë së Drejtësisë	Dialogu në përgjithësi dhe fusnota
4	14 korrik 2021	Diskutim	Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-014 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare për IPA 2020, ndërmjet Kosovës dhe BE-së" - i ftuar z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;	Dialogu në përgjithësi

**Tabela 2.5: Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatë sesionit pranveror (mars - gusht 2021)**

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	6 korrik 2021	Diskutim	Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2020, e ftuar: ministrja Rozeta Hajdari	Integrimi i Mbrojtjes Civile
2	13 korrik 2021	Diskutim	Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2020, I ftuar, Ministri Elbert Krasniqi	Integrimi i Mbrojtjes Civile
3	21 korrik 2021	Diskutim	Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020, I ftuar: ministri Xhelal Sveçla	Integrimi i Mbrojtjes Civile

**Tabela 2.6: Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, gjatë sesionit pranveror (mars - gusht 2021)**

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	5 maj 2021	Rend Dite	Raportim i kryetarit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Naser Shala, për punën e këtij institucioni për vitin 2020	Marrëveshja për regjistrat kadastral
2	19 korrik 2021	Diskutim	Kthimi i përgjigjes për Gjykatën Kushtetuese lidhur me rastin KO93/21	Vendimi i Kuvendit për mbulimin e energjisë elektrike në veri

|||||

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Projekti është mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Federal Department of Foreign Affairs FDFA**